

## Aktivitetet kryesore:

- Zhvillohet trajnimi 4 ditor i NSPK-ve të DVP Lezhe dhe Shkodër.
- Vazhdojnë trajnimet në vendin e punës të NSPK-ve të komisariatit të Elbasanit (të zonave urbane dhe të zonave rurale).
- Vazhdojnë aktivitetet në kuadër të skemës së granteve dhe të komponentit të dhunës në familje.

## Zhvillohet trajnimi 4 ditor i NSPK-ve të DVP Lezhë dhe Shkodër .



Gjatë muajit shkurt programi SCPA vazhdoi punën në mënyre intensive për trajnimin e NSPK-ve të drejtorive vendore të policisë të zonës së veriut të Shqipërisë. Kështu, gjatë datave 5-8 dhe 12-15 Shkurt 2019, u zhvillua në Lezhe trajnimi i NSPK-ve të DVP Lezhë të ndarë në 2 grupe prej 22 punonjësish policie (nga komisariatet e Lezhës, Mirditës dhe Kurbinit).

Ky grup trajnimesh u pasua nga 2 trajnime të NSPK-ve të DVP Shkodër. Trajnimet e këtyre grupeve u zhvilluan nga data 26, shkurt deri me 1 mars 2019. Ato u zhvilluan në Shkodër paralelisht në 2 grupe të përberë nga 24 ndihmës specialistë të Policimit në komunitet (nga komisariatet e Shkodrës, Malësisë së Madhe dhe Pukës). Trajnimet kishin për qëllim rritjen e aftësive profesionale për policimin në komunitet.



Ekspertët e programit SCPA në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë trajtuan gjerësisht temat teorike të tilla si PK si filozofi, sistemi dhe elementet e PK etj.

Një hapësirë e konsiderueshme iu dedikua trajtimit në mënyrë praktike të rolit, detyrave dhe përgjegjësive të NSPK-së, si dhe parandalimit në rendin publik, veprimit pro-aktiv në vend të atij reagues, bashkëpunimit të brendshëm në zonat policore si dhe bashkëpunimit me qytetarët dhe aktorët e tjerë të komunitetit etj.

Pjesëmarrësit patën rastin të shkëmbejnë eksperiencat e tyre dhe i ballafaquan ato me përvojat ndërkombëtare dhe të rajonit.

Ata e vlerësuan angazhimin, si dhe metodologjinë e përdorur dhe shprehen dëshirën për të pasur trajnime të ngjashme në të ardhmen.

**Vazhdojnë trajnimet në vendin e punës të NSPK-ve të komisariatit të Elbasanit (të zonave urbane dhe të zonave rurale)**

Gjatë muajit shkurt, ekspertët e SCPA kanë vazhduar trajnimin e NSPK-ve të komisariatit të Elbasanit



Trajnimi ka konsistuar në patrullime të përbashkëta të NSPK-ve + ekspertëve në terren (si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale) duke shqyrtuar rast pas rasti aktivitete të ndryshme si dhe duke ushtruar praktika të mira të trajtuara gjatë trajnimit të NSPK-ve apo dhe përvoja të kolegëve brenda sektorit.

Ky trajnim do të vazhdojë dhe në muajt në vijim.

## AKTIVITETE NË KUADËR TË SKEMËS SË GRANTEVE.

Edhe gjatë muajit shkurt janë realizuar një numër aktivitete në kuadrin e skemës së granteve. Peshën më të madhe në volum, e zënë aktivitetet vijuese nga muajt paraardhës të organizatave zbatuese.

Më poshtë po përmendim disa nga këto aktivitete:



Me datë 5 shkurt, Shoqata për Integrim Gjinator zhvilloi në sallën e mbledhjeve pranë Shkollës "Ardian Klosi" takim përmbyllës të projektit "Fuqizimi i ndërveprimit të komunitetit me policinë e shtetit" dhe organizimin e ekspozitës me punime të nxënësve të shkollave pjesëmarrëse me temë mbi policimin në komunitet dhe parandalimin e përdorimit të substancave narkotike.

Të pranishëm në këtë takim ishin drejtues shkollash, mësues, prindër, nxënës dhe përfaqësues të policisë së shtetit.

Në përfundim të ceremonisë u dhanë pesë çmime për punimet më të mira si dhe u ndanë me pjesëmarrësit rezultatet e arritura gjatë zbatimit të projektit dhe gjetjet e anketimit të kryer me nxënësit.



Yzberisht.

Organizata "Në Familje, për familjen", në kuadrin të Projektit "Forcimi i Policimit në Komunitet në zonat rurale, qarku Tiranë, zhvilloi në datë 18 Shkurt aktivitetin sensibilizues të radhës me mësues, prindër dhe nxënës të klasave të 8 dhe të 9 të shkollës 9-vjeçare



Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me komisariat nr 6 dhe specialistin e policimit në komunitet të zonës policore.

---

## Aktiviteteteve në lidhje me Dhunën në Familje dhe Dhunën me Bazë Gjinore.



Në kuadër të aktiviteteteve të komponentit të Dhunës në Familje, Ekipi i Manaxhimit të Projektit në bashkëpunim me bashkinë Elbasan dhe organizatën Forumi i Gruas Elbasan, zhvilloi në datën 6 Shkurt një takim midis anëtarëve të ekipeve teknike ndërdisiplinore të Bashkisë Elbasan, Gramsh dhe Belsh.

Synimi i këtij takimi ishte fuqizimi i mekanizmave të referimit përmes shkëmbimit të eksperiencës dhe ndarjes së praktikave më të mira, për ti ofruar një mbështetje të koordinuar dhe shërbime cilësore çdo viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore nga të gjithë institucionet vendore.



---

Në datën 22 shkurt 2019, pranë ambienteve të Hotel Destil, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim shënoi mbylljen e projektit "Krijimi i Grupeve kundër dhunës në familje në 4 Njësi Administrative të Bashkisë Tiranë". Të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësuesit e njësisve administrative



Baldushk, Farkë, Njësia Administrative 7 dhe Pezë, përfaqësues të policisë së shtetit si dhe ndërlidhës me komunitetin. Në këtë takim u diskutua gjerësisht mbi fenomenin e dhunës në familje, rolin e familjes, atë të komunitetit dhe shkollës si dhe u prezantuan gjetjet dhe rekomandimet për vazhdimësinë e aktiviteteteve të projektit.

Për më tepër informacion lutemi shikoni linkun ne faqen tone te web:  
<http://www.cp-project.al/web/grantet-veprimtarite/>